



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit  
SJ-019  
Prishtinë, më 22, 23 e 28 shkurt dhe më 20 e 21 mars 2018

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22, 23, 28 SHKURT DHE 20, 21 MARS 2018**

Seancën e jashtëzakonshme e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Në fillim të seancës, kryetari i njoftoi deputetët se në konsultim me kryetarët e të gjitha grupeve parlamentare është vendosur që seanca e jashtëzakonshme të mbahet të nesërmen, më 23 shkurt 2018, me fillim prej orës 10:00.

\* \* \*

*E premtë, më 23 shkurt 2018*  
*Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme*

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, sipas kërkesës së kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, me pikën e vetme të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi**

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se për ta shqyrtuar këtë Projektligj me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit nevojiten votat e 2/3 të deputetëve të pranishëm në seancë.

Ai kërkoi deklarinimin e kryetarëve e grupeve parlamentare për shmangie nga Rregullorja.

Lidhur me shmangien e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi diskutuan deputetët: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e dha një pauzë për konsultime.

Pas pauzës, kryetari i njoftoi deputetët se edhe pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare nuk është arritur konsensus për shmangie nga Rregullorja nga afatet procedurale.

Ai kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare për vazhdimin ode shtyrjen e seancës.

Lidhur për shtyrjen ose vazhdimin e kësaj seance, diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+” dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare për shtyrjen e vazhdimin të kësaj seance të jashtëzakonshme.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin e shumicës së grupeve parlamentare për shtyrjen e seancës së jashtëzakonshme për të mërkurën, më 28 shkurt 2018, në orën 10:00.

Kryetari i ndërpreu punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme më 23 shkurt 2018, në orën 12:10.

*E mërkurë, më 28 shkurt 2018*

*Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme*

Kryetari i hapi punimet për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, me pikën e vetme të rendit të ditës:

***1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi***

Kryetari kërkoi deklarin e grupeve parlamentare lidhur me shmangien nga afatet procedurale të Rregullores për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me shmangien e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi diskutuan deputetët: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Duda Balje, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin për shmangien e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,  
Kundër -----0,  
Abstenime -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### V E N D I M

Projektligji nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi shqyrtohet me shmangie të afateve procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

\* \* \*

Pastaj, kryetari e ftoi kryetarin e GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës për ta prezantuar Marrëveshjen e arritur ndërmjet subjekteve politike në lidhje me ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, e paraqiti dhe arsyetoi dakordimin e arritur ndërmjet GP të LDK-së dhe partive politike të Koalicionit qeverisës për procedimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari i Kuvendit kërkoi nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike që të tërhiqet nga seanca për ta përgatitur raportin me rekomandime dhe t’ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Kryetari dha pauzë deri sa Komisioni FunkSIONAL ta përgatisë raportin.  
Por, pas pauzës seanca nuk i vazhdoi punimet.

\* \* \*

*E martë, më 20 mars 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme*

Kryetari i hapi punimet për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, me pikën e vetme të rendit të ditës:

***1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi***

Kryetari i Kuvendit e ftoi kryeministri e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Kryeministri Ramush Haradinaj e paraqiti dhe arsyetoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Fjala e plotë e kryeministrit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani-Sadriu, që ta paraqesë raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, Vjosa Osmani-Sadriu, e paraqiti dhe arsyetoi raportin e Komisionit FunkSIONAL për projektligjin. Diskutimi i saj është dhënë i plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi diskutuan deputetët: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Visar Ymeri, në emër të GP “Deputetët e Pavarur”; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Allbert Kinolli, në emër të GP “6+”, Ilir Deda, Luljeta Veselaj Gutaj, Albulena Haxhiu, Blerim Kuçi, Milaim Zeka, Ismet Beqiri, Albin Kurti, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Mimoza Kusari-Lila, Xhevahire Izmaku, Rexhep Selimi, Daut Haradinaj, Haxhi Shala, Naser Rugova, Bekim Haxhiu, Arbërie Nagavci, Besa Gaxheri, Blerta Deliu-Kodra, Ali Lajçi, Drtiton Selmanaj, Sami Kurteshi, Elmi Reçica, Doruntina Maloku, Ismajl Kurteshi, Haxhi Avdyli, Fitore Pacolli, Fidan Rekaliu, Nait Hasani, Arbër Rexhaj, Arban Abrashi, Flora Brovina, Rasim Selmanaj, Xhelal Sveçla, Lumir Abdixhiku, Fatmire Kollçaku, Vjosa Osmani-Sadriu, Labinot Tahiri, Shemsi Syla, Drita Millaku, Nezir Çoçaj, Liburn Aliu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Salih Zyba, Hajdar Beqa, Valon Ramadani, Gani Dreshaj, Albulena Balaj-Halimaj, Arben Gashi, Islam Pacolli, Anton Quni, Kujtim Shala, Sala Berisha-Shala, Shkumbin Demaliaj, Ganimete Musliu, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministrat Enver Hoxhaj dhe Fatmir Limaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me kohën e votimit të Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi vendosi që seanca t'i vazhdojë punimet më 21 mars 2018, në orën 11:00.

Kryetari i ndërpreu punimet e kësaj seance më 21 mars 2018, në orën 0:55 minuta.

\* \* \*

E mërkurë, më 21 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme

Kryesoi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 92 deputetë dhe procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

***1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi***

Kryetari i Kuvendit e ftoi kryetarin e GP të LDK-së, Avdullah Hoti që ta paraqesë dhe arsyetojë amendamentin në këtë projektligj.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti tha se amendamenti duhet të rregullohet teknikisht, përkatësisht pika 2 e këtij amendamenti të bëhet 1.3.

pastaj, kryetari kërkoi nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike që të tërhiqet nga seanca dhe ta harmonizojë tekstin e amendamentit dhe t'ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Kryetari e dha një pauzë derisa Komisioni ta përgatisë raportin lidhur me amendamentin e propozuar.

Pas pauzës, kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe arsyetojë amendamentin e propozuar.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, znj. Vjosa Osmani, tha se Komisioni FunkSIONAL e ka harmonizuar tekstin e amendamentin në projektligj me ndryshimet e propozuara dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim.

Në momentin e procedimit të amendamentit për votim, deputetët nga radha Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Pasi nuk kishte kushte normale për punë, kryetari e dha edhe një pauzë.

Pas pauzës dhe ajrosjes së sallës së seancave plenare, seanca i vazhdoi punimet.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin në Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Deputetët nga radha Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” përsëri hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit me ç’rast u pamundësua zhvillimi e punimeve të seancës.

Kryetari dha përsëri pauzë dhe i ftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për t’u konsultuar për vazhdimin e seancës.

Pas pauzës, kryetari procedoi me votimin e amendamentit në Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Përsëri, për herë të tretë, deputetët nga radha Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit dhe u pamundësua zhvillimi i punimeve të seancës.

Kryetari e dha edhe një pauzë dhe i ftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për t’u konsultuar për vazhdimin e seancës.

\* \* \*

Pas pauzës, kryetari procedoi me votimin e amendamentit në Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Përsëri, për herë të katërt, deputetët nga radha Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit dhe u pamundësua zhvillimi i punimeve të seancës.

Kryetari dha pauzë dhe i ftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për t’u konsultuar për vazhdimin e seancës..

Pas pauzës, seanca i vazhdoi punimet në orën 18:50 minuta.

Kryetari konstatoi se në sallë janë pranishëm 92 deputetë.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 80,  
Kundër -----11,  
Abstenime -----0.

Kuvendi e miratoi amendamentin e propozuar nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 80,  
Kundër -----11,  
Abstenime -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë të kualifikuar mori këtë:

#### V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme më 21 mars, në orën 18:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*